

Dr. Haki Kasumi

NJË STUDIM ME VLERË SHOQËRORE-JURIDIKE

(Mr. Halim Kuliqi, *Viktima e delikteve të gjakut në Kosovë*, Prishtinë, 2003, 15)

Studimi i Mr. Halim Kuliqit “Viktima e delikteve të gjakut në Kosovë” që kohë më parë doli nga shtypi, e të cilin sot po e promovojmë, paraqet një kontribut për shkencën në përgjithësi, ndërkaq kontribut të rëndësishëm dhe të veçantë për lëmin e juridikaturës. Pas leximit të vëmendshëm kam vërejtur se autori u është përmbajtur kriterëve të nevojshme të një studimi të mirëfilltë shkencor. Po përmendim katër prej tyre:

1. Për trajtimin e fenomeneve të caktuara shoqërore autori në këtë studim është mbështetur në baza të mirëfillta shkencore,
2. Metodologjia e aplikuar e punës autorit i ka krijuar mundësi që çështjet e shtruara të trajtohen mbështetur në baza dhe kërkesa të parimeve të shkencës bashkohore,
3. Libri është mbështetur në dokumente arkivale të gjykatave përkatëse dhe se ato janë zgjedhur dhe interpretuar në bazë të kriterëve të duhura shkencore
4. Literatura e zgjedhur është përdorur vetëm si plotësim i burimeve të dorës së parë dhe ajo është aplikuar gjithëherë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e shkencës bashkëkohore.

Janë këto disa nga veçoritë që e përshkojnë librin e z. Kuliqi dhe të cilat e bëjnë atë vepër me rëndësi të duhur për shkencën dhe një studim me vlerë shoqërore politike, si dhe kombëtare. Vlera e këtij studimi qëndron mu në momentin aktual dhe institucional të zhvillimit të shoqërisë shqiptare në Kosovë.

Këto janë vetëm disa nga karakteristikat e përgjithshme të cilat i kam vënë gjatë leximit të librit e për të cilat jam i bindur se autori është konsultuar me profesorët-recensentët e tij dhe konsideroj se kjo është edhe meritë e tyre.

Do të ndalem pak në dimensionin historik të fenomenit shoqëror të emërtuar si VIKTIMA E DELIKTEVE TË GJAKUT në hapësirën e Kosovës. Krimi si fenomen negativ siç vë në dukje edhe autori, është i vjetër sa edhe vetë shoqëria njerzore. Ai si i tillë gjithëherë e ka shoqëruar edhe viktimën e tij-njeriun dhe sidomos njeriun shqiptar për një kohë të gjatë. Në vijim autori i këtij studi-

mi, z. Kuliqi duke bërë fjalë për llojet e krimeve dhe për viktimen me të drejtë ndalet dhe shtrihet në kohë dhe në hapësirë dhe bën fjalë edhe për viktimat e terrorit shtetëror të Serbisë mbi shqiptarët, më vështrim të veçantë në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX. Ai me shkathtësi e mjeshtri të rrallë të një studiuesi të zellshëm vë në spikamë një pjesë të mirë të veprimeve kriminale të terrorit shtetëror serb mbi shqiptarët të ushtruar në kontinuitet në të gjitha përballjet me këtë popullatë të urtë dhe të pambrojtur. Veprimet e tilla kriminale gjithëherë u kryen në viset etnike shqiptare, por që ishin cak i synimeve pushuese të pushteteve hegjemoniste serbo-malazeze, përkatësisht jugosllave.

Po ashtu, në pjesën hyrëse të kreut III të librit, autori në titull të veçantë parashtrohet "DISA FJALË PËR TERRORIZMIN" ku në mënyrë të thuktë janë evidencuar rastet më karakteristike të veprimeve kriminale të terrorit shtetëror serb kundër shqiptarëve, duke filluar nga veprimet fillestare për zbatimin e projektit të parë antishqiptar më 1877-78 kur me dhunë e terror shtetëror, duke vrarë e therur, u debuan në mënyrë masive shqiptarët prej viseve të tyre etnike nga Sanxhaku i Nishit. Veprime të tilla të një pushteti kriminal kundër popullatës shqiptare pati edhe gjatë viteve 1892-1894; 1912-1915; 1918-1921; 1945-1966; 1968; 1981; 1989 dhe së fundi përpjekja për zbatimin praktik të projektit për shfarosjen e shqiptarëve të 24-tit me radhë me të cilin ishte planifikuar që përvjetori i 610-të i Betejës së Kosovës të imagjinuar nga kasta serbe të kremtohej në Kosovën e pastruar nga shqiptarët.

Për të gjitha këto veprime kriminale të terrorit sistematik shtetëror serbo-jugosllav nga dokumentacioni i ruajtur arkival mund të shkruhen edhe shumë e shumë studime të lëmennjeve të ndryshëm si juridikë historikë ashtu edhe të tjerë, me të cilët ne intelektualët shqiptarë kemi obligim të nxjerrim në shesh një pjesë të së vertetës së hidhur me të cilën është përballur populli ynë. Kemi obligim të themi të vertetën se vazhdimisht kemi qenë në pozitën e viktimës së pafajshme dhe se kuptimi apo definicioni i porosive të këtij libri për deliktet e gjakut na shtyn të mendojmë se të gjitha ato veprime të pushtetit kriminal serb kan pasur si pasojë derdhjen e shumë tonelatave gjaku të një populli të pafajshëm. Mbështetur në parimet themelore të shkencave humanitare dhe në parimet e humanizmit e të demokracisë, të proklamuar në dokumentet aktuale ndërkombëtare jemi të thirrur ta ndriçojmë realitetin objektiv shkencor e që në rastin konkret është edhe kërkesë dhe porosi e librit për të cilin po flasim. Në rastin tonë konkret është përcaktimi sa më i përafërt i sasisë së gjakut të popullit shqiptar të derdhur në përballjet me pushtetet kriminale serbe dhe në luftën e tij të drejtë për realizimin e një të drejte elementare njerëzore të garantuar me dokumentet ndërkombëtare. Me një punë të organizuar e të mirëfilltë të intelektualëve dhe të institucioneve shqiptare, gjithëherë duke u mbështetur në argumente e fakte të bollshme, do të mund ta përbalnim Serbinë me një gjykatë të mirëfilltë ndërkombëtare, gjithëherë duke u nisur nga parimi se veprimet kriminale kurrë nuk vjetrohen. Por, po e theksoj në një gjykatë të mirëfilltë ndërkombëtare e jo si kjo e Hagës ku po vërehen tendenca të barazimit të kriminelit me viktimen ku po tentohet të fajësohen dhe të gjykojnë çlirimtarët, gjë që është raritet në botën bashkëkohore të fillim- shekullit XXI.